



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 83-të të mbajtur më 27.02.2023 ka miratuar si në vijim.

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-6552/1 datë 09.12.2022, kundër personit -----
----, HIDHET POSHTË .

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë për arsye se e njëjta është dorëzuar te organet tjera .

Lënda me numër 12-6552/1 të vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur ----- nga -----, më datë 09.12.2021 është dorëzuar denoncim për personin ----- dhe është formuar lënda me numër 12 -6552/1 të datës 09.12.2021.

Në denoncim, parashtruesi thekson se në parcelën me nr. PK -----/1 ka pasur një gardh të ndërtuar pa leje që e ndan parcelën në dy pjesë dhe është vendosur nga personi -----
--, i cili nuk ka të regjistruar në pronësi dhe e drejta e shfrytëzuesit në parcelën e përmendur, e cila ndodhet në territorin e Komunës -----.

Parashtruesi në denoncim thekson se pretendimet në ia kanë adresuar edhe Komunës së -----, dhe gjithashtu ka pasur një procedurë gjyqësore që ka rezultuar me Aktgjykim me

U. nr. -----/----- të ----- vitit, në të cilin është konstatuar se objekti është objekt i ndërtuar pa leje.

Me vendimin e marrë nga Komuna ----- personi ----- kishte bërë ankesë në organin e shkallës së dyt.

parashtruesi kërkon që KSHPK-ja të angazhohet për këtë çështje në mënyrë që të zgjidhë problemin dhjetëvjeçar që kanë pasur, përfshirë kontrollin mbi zbatimin e kompetencave ligjore të Komunës ----- në lidhje me pretendimet në denoncim.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja ka konstatuar se në rastin bëhet fjalë për pretendime që nuk janë objekt i veprimit të saj kompetent.

Duke pasur parasysh se denoncimi është dorëzuar edhe në Komunën e -----, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale si autoritete vendimmarrëse në fushën e caktuar si dhe Avokaturës Shtetërore, Avokati i Popullit, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi .

Dorëzuar deri:

- Parashtruesi
përgatiti: Mr. K.Z

KOMISIONI SHTETËRORE
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Nënkryetar
Katica Nikolovska